

MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 185/1 Prot.

Tiranë, më 15.09 2017

VENDIM QARKULLUES Nr. 197, datë 15.09.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë së Përgjithëshme të Entit Kombëtar të Banesave, për shqyrtim e vendimmarrje në lidhje me Raportin e Sondazhit Arkeologjik në sheshin e ndërtimit, ku do zhvillohet projekti "*Objekt banimi dhe shërbimesh 6 kat + 1 kat nëntokë, me vendndodhje në rrugën "Stefan Kaçulini", zona arkeologjike "B", Durrës*-subjekti "Drejtoria e Përgjithëshme e Entit Kombëtar të Banesave" sh.a., realizuar nga DRKK Durrës.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Sondazhit Arkeologjik në sheshin e ndërtimit, ku do zhvillohet projekti "*Objekt banimi dhe shërbimesh 6 kat + 1 kat nëntokë, me vendndodhje në rrugën "Stefan Kaçulini", zona arkeologjike "B", Durrës*-subjekti "Drejtoria e Përgjithëshme e Entit Kombëtar të Banesave" sh.a., realizuar nga DRKK Durrës.
2. Të kryhet nga DRKK Durrës ndjekja periodike ditore e punime të gërmimit për "Objekt banimi dhe shërbimesh 6 kat + 1 kat nëntokë" me vendndodhje në rrugën "Stefan Kaçulini", zona arkeologjike "B", Durrës.
3. ASHA të verifikojë raportet e terrenit, të depozituar pranë saj nga DRKK Durrës, e cila do të kryejë ndjekjen periodike ditore të punimeve të gërmimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al